



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:913286

Datë: 19.06.2024

Numri i dokumentit: 05836171

C.nr.2819/22

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Blerand Rrmoku, në çështjen juridike kontestimore ndërmjet paditëses Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a, me seli në Prishtinë, sheshi “Nëna Terezë” nr.36, e përfaqësuar në bazë të autorizimit nga B.K - jurist, kundër të paditurit L.B nga P, lagja D, Rr. “A.J” nr..., me objekt kontesti lirim të paluajtshmërisë, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor - publik të dt.14.06.2024, në rigjykim, në prezencën e përfaqësuesit të autorizuar të paditëses, e në mungesë të palës së paditur, me datë 19.06.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET NË TËRËSI si e pa bazuar kërkesëpapia e paditëses Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a, me seli në Prishtinë, përmes së cilës ka kërkuar që të detyrohet i padituri L.B nga P, që ta lirojë nga njerëzit dhe sendet dhe t’ia dorëzojë paditëses paluajtshmerinë e cila gjendet në fshatin G.P, vendi i quajtur “B”, e cila evidentohet si ngastra kadastrale P-345-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 441 m², ZK F.K, si dhe ta rrënojë objektin - strukturën ndërtimore në sipërfaqe prej 62 m², të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të kësaj procedure.

A r s y e t i m

- Rrjedha e procedurës dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse -

Pranë ish - Gjykatës Komunale në Prishtinë, fillimisht është zhvilluar procedura kontestimore sipas padisë së paditësit L.B nga P, të ushtruar me datë 21.02.2007, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimin e paluajtshmërisë së shpronësuar, lëndë kjo e cila është evidentuar nën shenjën C.nr.382/07. Në padi ndër tjera është theksuar se me aktvendimin për eksproprijim të Sekretariatit për Financa të Kuvendit Komunal të Prishtinës, të datës 20 korrik 1964 është eksproprijuar patundshmëria e cila gjendet në fshatin G.U, parcela kadastrale nr.345, me kulturë oborr, në sipërfaqe prej 0,04.41 ha dhe kullosë e klasit të II-të, në sipërfaqe prej 0,59.07 ha, fleta poseduese nr.84 dhe 228 KK, G.U, në dobi të Elektroekonomisë së Kosovës. Tutje pretendohet se për parcelat e eksproprijuara, paditësi nuk ka marrë kurrfarë kompensimi për shkaqe të panjohura, ndërsa lidhur me këtë

çështje i është drejtuar organit kompetent për eksproprijim - Sekretariatit për Financa të Kuvendit të Kosovës, të cilën shumë është dashur ta sigurojë shfrytëzuesi i eksproprijimit, i cili organ me aktvendimin 07 nr.465-15/84, të dt.10.01.1985, e ka refuzuar kërkesën për anulimin e vendimit për eksproprijim nr.04/2-7085, të datës 23.04.1964, si të pa bazuar. Më tej ka pretenduar se në bazë të nenit 29 të Ligjit mbi Eksproprijim, paditësit i takon e drejta në kompensim, andaj në petitum të kërkesëpadisë ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet e paditura, që në emër të kompensimit për eksproprijim në bazë të aktvendimit nr.04/2-7085, të datës 23.04.1964, të parcelës kadastrale 345, shtëpi në sipërfaqe prej 62 m² dhe oborr në sipërfaqe prej 0,03.79 ha dhe nr.640, arë e klasit të III-të, në sipërfaqe prej 0,59.07 ha nga fletat poseduese nr.80 dhe 128 KK G.U, t'ia paguajë shumën e cila do të përcaktohet sipas ekspertit përkatës, dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit.

Gjykata Komunale në Prishtinë, përmes aktvendimit C.nr.382/07, të dt.26.09.2012, në pikën I të dispozitivit të aktvendimit e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit L.B nga P, ndërsa në pikën II të dispozitivit ka vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, duke vepruar sipas ankesës së paditësit, me aktvendimin Ac.nr.859/2013, të dt.23.06.2015, e ka anuluar aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr.382/2007, të datës 26.09.2012 dhe lëndën e ka kthyer në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim, me ç'rast lënda ka marrë numrin C.nr.1528/15.

Me rastin e parashtrimit të përgjigjes në padi, të deponuar në Gjykatë me dt.08.07.2016, e paditura Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a, me seli në Prishtinë, ka parashtruar kundërpadi ndaj paditësit L.B, lidhur me lirimin e paluajtshmërisë nga njerëzit dhe sendet, mbi bazën e pretendimit se paditësi pa kurrfarë baze juridike dhe pa pëlqimin e të paditurës është duke e shfrytëzuar paluajtshmërinë kontestuese, në të cilën ka të ndërtuar objekte banimi prej materialit të fortë me dimensione të ndryshme, duke e pamundësuar në këtë mënyrë shfrytëzimin e paluajtshmërisë për të paditurën. Në seancën përgaditore të mbajtur me datë 16.11.2018, Gjykata ka marrë aktvendim me të cilin e ka lejuar kundërpadinë.

Përmes parashtresës së deponuar në Gjykatë me dt.28.12.2018, paditësi L.B e ka tërhequr padinë kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a, me seli në Prishtinë, ndërsa Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.06.02.2019, pas dhënies së pëlqimit nga pala e paditur, ka marrë aktvendim me të cilin ka konstatuar se paditësi - kundër i padituri L.B e ka tërhequr padinë ndaj të paditurës - kundërpaditëses Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a, me seli në Prishtinë, lidhur me kompensimin e paluajtshmërisë së shpronësuar. Me këtë rast, lënda ka vazhduar të procedohet sipas kundërpadisë së të paditurës, tani në cilësinë e paditëses. Në të njëjtën seancë, kundërpaditësja, e cila ka marrë cilësinë e paditëses, e ka bërë ndryshimin e padisë në aspektin subjektiv, ashtu që në vend të paditësit - kundër të paditurit L.B, e ka paditur E.B me vendbanim në fshatin G, Komuna F.K, ndërsa Gjykata ka marrë aktvendim me të cilin duke iu referuar dispozitës nga neni 257 të LPK-së, e ka lejuar ndryshimin e padisë në aspektin subjektiv, duke vendosur që tani e tutje procedura do të zhvillohet sipas padisë së

paditëses Korporata Energjetike e Kosovës, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit E.B nga fshati G, Komuna F.K, me objekt kontesti lirim e paluajtshmërisë.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, përmes aktgjykimit C.nr.1528/15, të dt.11.04.2019, e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses Korporata Energjetike e Kosovës, me seli në Prishtinë dhe e ka detyruar të paditurin E.B nga fshati G, Komuna F.K, ta lirojë nga njerëzit dhe sendet paluajtshmerinë e cila gjendet në fshatin G.P, vendi i quajtur "B", me numër të parcelës P-345-0 në sipërfaqe prej 441 m2, ZK F.K, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, duke vepruar sipas ankesës së parashtruar nga i autorizuari i të paditurit E.B, av. S.B, përmes aktvendimit Ac.nr.3691/19, të dt.12.05.2022, e ka anuluar aktgjykimin e lartëcekur të shkallës së parë dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje në të njejtën Gjykatë. Në arsyetimin e këtij aktvendimi ndër tjera është konstatuar se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar dispozitën nga neni 260 par.1 dhe 2 të LPK-së, kur me aktvendim procedural në të njejtën seancë e ka konstatuar të tërhequr padinë e paditësit - kundër të paditurit L.B ndaj të paditurës - kundërpaditëses KEK, duke e lejuar më pas edhe ndryshimin e padisë (kundërpadisë) në aspektin subjektiv, ashtu që në vend të paditësit - kundër të paditurit L.B, ka vazhduar procedurën ndaj të paditurit E.B, pa e marrë pëlqimin e këtij të fundit. Në këtë mënyrë, Gjykata e shkallës së parë është udhëzuar që në riprocedim të evitojë të metat e theksuara më sipër, duke e ftuar të paditurin E.B që të deklarohej nëse pajtohet të futet si i paditur në procedurë, në vend të të paditurit të deritanishëm L.B, ndërsa nëse personi ndaj të cilit është ndryshuar padia nuk e jep pëlqimin që të hyjë si palë e paditur, atëherë Gjykata është udhëzuar që të veprojë në kuptim të nenit 260 par.1 dhe 2, lidhur me nenin 258 par.1 dhe 2 të LPK-së, duke mos e lejuar ndryshimin e padisë në aspektin subjektiv, ndërsa nëse jepet pëlqimi, atëherë të procedojë tutje dhe në bazë të vlerësimit të provave të administruara të vendosë lidhur me kërkesëpadinë e paditëses.

Në riprocedim lënda ka marrë numrin C.nr.2819/22. Gjykata, duke vepruar sipas vërejtjeve dhe udhëzimeve nga aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3691/19, të dt.12.05.2022, e ka ftuar të paditurin që në kuptim të nenit 258, lidhur me nenin 260 par.2 të LPK-së, të deklarohej lidhur me ndryshimin e padisë në aspektin subjektiv, gjegjësisht nëse e jepë pëlqimin për të hyrë si palë e paditur në këtë procedurë.

Përmes një parashtrëse të deponuar në Gjykatë me dt.15.11.2023, i padituri E.B, ka deklaruar se nuk mund të jetë palë në këtë kontest gjyqësor, duke shtuar se nuk e jep pëlqimin për të hyrë në procedurë. Mbi bazën e një rrethane të tillë, Gjykata përmes aktvendimit procedural në seancën përgaditore të dt.18.04.2024, e ka refuzuar ndryshimin e padisë në aspektin subjektiv, duke vendosur që tani e tutje procedura do të vazhdojë sipas padisë së paditëses Korporata Energjetike e Kosovës, kundër të paditurit L.B.

Në seancat e mbajtura në riprocedim, përfaqësuesi i autorizuar i paditëses, B.K ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklarimeve dhe pretendimeve të mëhershme, ndërsa nuk ka propozuar nxjerrjen e provave të reja, duke kërkuar që pas administrimit të provave Gjykata të marrë

aktgjykim me të cilin detyrohet i padituri L.B nga P, ta lirojë nga njerëzit dhe sendet dhe t'ia dorëzojë paditëses paluajtshmërinë e cila gjendet në fshatin G.P, vendi i quajtur "B", e cila evidentohet si ngastra kadastrale P-345-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 441 m², ZK F.K, si dhe ta rrënojë objektin - strukturën ndërtimore në sipërfaqe prej 62 m², të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit. Po ashtu, i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 250.00 Euro.

Gjykata letërthirren për seancë përgaditore, respektivisht atë të shqyrtimit kryesor për të paditurin L.B, në kuptim të dispozitës nga neni 116 të LPK-së, e ka afishuar në tabelën e shpalljeve të Gjykatës. Meqenëse i padituri, përkundër faktit që ka qenë i njoftuar në mënyrë të rregullt nuk ka prezantuar, Gjykata ka proceduar me mbajtjen e këtyre seancave në mungesë të palës së paditur, në kuptim të dispozitës nga neni 409 par.2, respektivisht 423 par.4 të LPK-së.

- Gjendja faktike e vërtetuar mbi bazën e provave të administruara -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje kontestimore, Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.14.06.2024, në cilësinë e provave materiale, ka administruar provat provat e administruara sipas procesverbalit të seancës së shqyrtimit kryesor të dt.11.04.2019 në lëndën e cila është evidentuar nën shenjen C.nr.1528/18, dhe atë:

-Kërkesa për deeksprijim e parashtruar nga B.B nr.07-465-15, e dt.14.03.1984; Aktvendimi i Sekretariatit për Financa të Komunës së Prishtinës nr.07-465-15/84, e dt.10.01.1985; Certifikata mbi të drejtat e paluajtshmërisë UL-72514028-00129, e dt.11.08.2010; Aktvendimi mbi eksproprijim nr.04/2-7085, e dt.23.04.1964; Regjistri i Komisionit për Regjistrimin e patundshmërive, me numër rendor 139, në emër të B.A.B; Procesverbali i vendshiqimit i dt.23.11.2018; Ekspertiza e gjeodezisë e përpiluar nga eksperti A.A, e dt.03.12.2018 me skicën e bashkangjitur; Kopja e letërnjoftimit në emër të E.B, e lëshuar me datë 15.07.2011 nga MPB në Prishtinë; Plani hapësinor - zona me interes të veçantë fusha e mihjes së re.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditëses, prezent në seancë, nuk ka parashtruar vërejtje në raport me provat e administruara.

Gjykata në mbështetje të dispozitës nga neni 8 të LPK-së, me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar secilën provë veç e veç, e më pas të gjitha provat së bashku, me ç'rast ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Nga aktvendimi mbi eksproprijim nr.04/2-7085, i dt.23.04.1964, konstatohet fakti se është bërë eksproprijimi i paluajtshmërisë e cila evidentohet sipas fletës poseduese nr.80, G.U, e evidentuar në emër të ish - pronarëve B.D.A dhe B.A.B nga fshati G.U, Komuna F.K, me ç'rast është bërë eksproprijimi dhe kompensimi i ngastrave nr.345, shtëpia me sipërfaqe prej 62 m² dhe truallit në sipërfaqe prej 379 m², si dhe ngastrës kadastrale nr.640, arë e klasit të III-të, në sipërfaqe prej 0,59.07 ha.

Në bazë të aktvendimit të Sekretariatit për Financa të Komunës së Prishtinës nr.07-465-15/84, e dt.10.01.1985, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga këtu i padituri L.B, me të

cilën është kërkuar anulimi i aktvendimit mbi eksproprijim nr.04/2-7085, i dt.23.04.1964, sipas të cilit aktvendim është bërë eksproprijimi (shpronësimi) i paluajtshmërisë kontestuese e cila gjendet në fshatin G.P, vendi i quajtur “B”, e cila evidentohet si ngastra kadastrale P-345-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 441 m2, ZK F.K, në dobi të paditëses, për nevoja të ndërtimit të mihjes sipërfaqësore në B.M dhe G.U.

Nga certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme, me numër UL-72514028-00129, e lëshuar me dt.11.08.2010, nga Komuna e Fushë Kosovës, konstatohet fakti se paluajtshmëria kontestuese - ngastra kadastrale me numër P-72514028-00345-0, e cila gjendet në vendin e quajtur “B”, në sipërfaqe të përgjithshme prej 441 m2, Zona Kadastrale G.P, evidentohet në pronësi të këtu paditëses Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Sh.a, me seli në Prishtinë.

Nga kopja e planit hapësinor - Zona me Interes të Veçantë “Fusha e Mihjes së Re”, e përpiluar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, është konstatuar se: *“Hapësira brenda kufirit evidentues të zonës me interes të veçantë ekonomik ka sipërfaqe prej 14.986 Ha (hektarëve); Hapësira brenda kufijve të mihjes së re në kuadër të basenit të Kosovës duhet ruajtur ekskluzivisht për aktivitetet minerare; Hapësira e minierës së re duhet të zhvillohet në mënyrë graduale duke shpalosur linjitin e në të njejtën kohë duke mbuluar hapësirat e shfrytëzuara; Në vendbanimet që duhet të zhvendosen, sipas avancimit të zhvillimeve bazuar në Planin Kryesor Minerar, autoritetet kompetente marrin vendime mbi ndalimin e ndërtimeve të reja sipas inventarizimit të pasurisë së paluajtshme. Ndërtimet e objekteve të reja të banimit, për periudhën pas marrjes së vendimit nga autoritetet kompetente mbi ndalimin e ndërtimit të tyre, deri para fillimit të procesit të zhvendosjes, konsiderohen ndërtime ilegale dhe nuk kompensohen...”*

Nga procesverbali i këqyrjes në vend, C.nr.1528/15, i përpiluar me datë 23.11.2018, është konstatuar: *“Gjykata me ndihmën e ekspertit konstatoi se bëhet fjalë për parcelën 345-0... Konstatojmë se në këtë parcelë është e ndërtuar një shtallë me material të vjetër, ku thuhet se janë të vendosura kafshët - pronë e E.B... Më gjerësisht eksperti do të japë mendimin dhe konstatimin në formë të shkruar.”*

Nga mendimi dhe konstatimi me shkrim, i përpiluar nga eksperti Afet Axhami, me dt.03.12.2018, të cilit i është bashkangjitur edhe skica e ngastrës kontestuese, është konstatuar se ngastra kadastrale P-345-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej S=441 m2, dhe atë 379 m2 industri, kurse 62 m2 shtëpi, në vendin e quajtur “B”, lloji i shfrytëzimit të parcelës për industri apo miniera, ZK G.P, Komuna F.K, evidentohet në emër të “KEK” Sh.a. Lidhur me historikun e kësaj ngastre është konstatuar se të njejtat nuk posedojnë asnjë ndryshim nga të dhënat tjera të mëhershme, ndërsa tutje është theksuar se që nga koha e eksproprijimit, sipas aktvendimit nr.04/2-7085, të datës 23 prill 1964 janë bartur apo regjistruar pranë shërbimit kadastral në emër të Korporatës Energjetike të Kosovës. Tutje sipas kësaj ekspertize është konstatuar se ngastra 345-0 nuk gjendet në sipërfaqen e shfrytëzuar apo ku është bërë eksploatimi i lëndës së parë nga KEK-u dhe nuk është shfrytëzuar për nxjerrjen e lëndës së thëngjillit, por në të gjendet një objekt i përshtatur me material të vjetër dhe të dobët ndërtimor, ku shfrytëzohet si shtallë për mbajtjen e kafshëve shtëpiake. Për fund është konstatuar se parcela në fjalë, si dhe të gjitha parcelat që

kufizohen rreth saj, duke filluar nga parcelat 344-0, 346-0, 377-0 etj..., janë parcela që evidentohen në emër të Korporatës Energjetike të Kosovës.

- Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i Gjykatës -

Në funksion të vlerësimit të bazës ligjore të mbështetjes së kërkesëpadisë, gjegjësisht pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, bazuar në natyrën dhe periudhën e lindjes së raportit juridik, duhet t'i referohemi dispozitave të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore (tani e tutje LMTHJP), i aprovuar në Kuvendin e RSFJ, në seancën e Dhomës Federative me datë 30 janar 1980, ligj ky i cili ka hyrë në fuqi me datën 01 shtator 1980 (në kuptim të nenit 90). Ligji i lartëcekur ka gjetur aplikim deri me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 15.06.2009 dhe i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit. Dispozita nga neni 3 e LMTHJP-së, e cila i referohet autorizimeve të pronarit përcakton që: "*Pronari ka të drejtë që sendin e vet ta mbajë, ta shfrytëzojë dhe ta disponojë në kufijtë e caktuara me ligj*". Mënyrat e fitimit të të drejtës së pronësisë parashihen me dispozitën e nenit 20 të këtij ligji, ku përcaktohet: "*E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim. E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj*". Së fundmi, dispozita nga neni 37 e këtij ligji, e cila i referohet mbrojtjes së të drejtës së pronësisë përcakton: "*Pronari mund të kërkojë me padi nga mbajtësi kthimin e sendit të caktuar në mënyrë individuale. Pronari duhet të provojë se mbi sendin kthimin e të cilit e kërkon ka të drejtën e pronësisë dhe se sendi gjendet nën zotërimin faktik të të paditurit. E drejta e paraqitjes së padisë nga paragrafi 1 i këtij neni nuk parashkruhet.*"

Në bazë të interpretimit të dispozitës së lartëcituar nga neni 37 e LMTHJP-së, rrjedh se në rastet kur objekt i të shqyrtuarit paraqitet kërkesa për kthimin e sendit të caktuar, duhet vlerësuar nëse kanë ardhur në shprehje dy rrethana bazike: 1) Të provuarit e faktit nëse subjekti i cili kërkon mbrojtje gjyqësore ka të drejtën e pronësisë mbi sendin, kthimin e të cilit e kërkon dhe 2) Të provuarit e faktit se sendi, kthimi i të cilit kërkohet gjendet nën zotërimin faktik të të paditurit. Rrethanat e lartëcekura duhet vlerësuar në mënyrë kumulative.

Pronësia si institut paraqet pushtetin e tërësishëm (absolut) të pronarit mbi një send të caktuar dhe përfshin në vete autorizimet e pronarit që atë send ta mbajë, shfrytëzojë dhe të disponojë brenda kufijve të caktuar me ligj. Në çdo rast kur pronarit i cenohet pushteti faktik mbi sendin, ai ka të drejtën e mbrojtjes gjyqësore për realizimin e të drejtës subjektive.

Në referim të dispozitave të lartëcekura, përqendrimi i vëmendjes nga ana e Gjykatës duhet të orientohet fillimisht drejt vlerësimit të raportit juridik mes paditëses Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a, me seli në Prishtinë dhe paluajtshmërisë kontestuese, si dhe raportit faktik mes këtu të paditurit L.B me paluajtshmërinë në fjalë.

Sa i përket rrethanës së parë, Gjykata konstatoi se paditësja ka arritur ta provojë faktin se është pronare e vetme e paluajtshmërisë kontestuese, e cila evidentohet si ngastra kadastrale P-345-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 441 m², dhe atë 379 m² e shfrytëzuar si industri, ndërsa 62 m²

si shtëpi, e cila gjendet në vendin e quajtur “B”, Zona Kadastrale G.P, Komuna F.K. Pronësinë e kësaj ngastre, paditësja e ka fituar mbi bazën e aktvendimit mbi eksproprijim nr.04/2-7085, të dt.23.04.1964, i cili njëherit ka shërbyer edhe si titull juridik për regjistrimin e kësaj paluajtshmërie pranë organeve kompetente në regjistrat publikë të paluajtshmërive. Një fakt i tillë është pasqyruar edhe në bazë të provave materiale si: certifikata mbi të drejtat e paluajtshmërisë UL - 72514028-00129, të dt.11.08.2010, e në veçanti mendimi dhe konstatimi me shkrim nga ana e ekspertit nga lëmia e gjeodezisë A.A, i përpiluar me dt.03.12.2018.

Lidhur me rrethanën e dytë, që ka të bëjë me të provuarit e faktit nëse paluajtshmëria kontestuese gjendet nën zotërimin faktik të të paditurit L.B, Gjykata fillimisht iu referua procesverbalit të këqyrjes në vend, nën shenjën C.nr.1528/15, të përpiluar me datë 23.11.2018, në të cilin është konstatuar: *“Gjykata me ndihmën e ekspertit konstatoi se bëhet fjalë për parcelën 345-0... Konstatojmë se në këtë parcelë është e ndërtuar një shtallë me material të vjetër, ku thuhet se janë të vendosura kafshët - pronë e E.B... Më gjerësisht eksperti do të japë mendimin dhe konstatimin në formë të shkruar”*. Në ndërlidhje me konstatimet dhe të gjeturat nga nxjerrja e provës përmes këqyrjes në vend, Gjykata iu referua edhe mendimit dhe konstatimit me shkrim nga eksperti i gjeodezisë A.A, në të cilin mes tjerash është konstatuar se *“Parcela kadastrale nr.345-0, nuk është shfrytëzuar për nxjerrjen e lëndës së thëngjillit, por në të gjendet një objekt i përshtatur me material të vjetër dhe të dobët ndërtimor, ku shfrytëzohet si shtallë për mbajtjen e kafshëve shtëpiake.”*

Mbi këtë bazë, Gjykata nga provat e administruara e të elaboruara më sipër, e merr të provuar faktin se ngastra kadastrale kontestuese është nën zotërimin faktik të E.B, e jo të këtu të paditurit L.B.

Në këtë kuptim, meqenëse nuk është provuar rrethana e dytë e kërkuar nga neni 37 i LMTHJP - së, respektivisht të provuarit e faktit se i padituri L.B është nën zotërim faktik të paluajtshmërisë, kthimi i të cilës është kërkuar, vlerësimi i Gjykatës konsiston në faktin se paditësja nuk mund ta gëzojë beneficinin e përcaktuar me dispozitën e lartëcekur, gjegjësisht nuk mund ta kërkojë kthimin e sendit nga këtu i padituri, por një kërkesë e tillë duhet të drejtohet pikërisht ndaj subjektit i cili e ka zotërimin faktik të paluajtshmërisë lëndore. Në fakt, pala e paditur në procedimin e mëhershëm, me rastin e marrjes së provës përmes këqyrjes në vend, respektivisht ekspertizës nga lëmia e gjeodezisë, e ka bërë ndryshimin e padisë në aspektin subjektiv, duke e paditur personin fizik E.B, mirëpo në kuptim të vërejtjeve dhe sugjerimeve të Gjykatës së Apelit, meqenëse i njejtë në riprocedim nuk e ka dhënë pëlqimin për të hyrë si palë në këtë procedurë, Gjykata e ka refuzuar ndryshimin e tillë. Në dritën e një rrethane të tillë, meqenëse procedura është vazhduar ndaj të paditurit L.B, Gjykata në kuptim të dispozitës nga neni 2 par.1 të LPK-së, është e obliguar që të vendosë brenda kufijve të kërksave të parashtruara në procedurë.

Në raport me vlerësimin e ekspertizës nga lëmia e gjeodezisë, Gjykata ia fali besimin e plotë në pikëpamje të vërtetimit të rrethanave dhe fakteve që kanë qenë të rëndësishme dhe me peshë vendimtare për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike në këtë çështje kontestimore. E njejtë është përpiluar në mënyrë profesionale, mbi bazën e të gjithë parametrave dhe standardeve të kërkuara dhe për më tepër të gjeturat e kësaj ekepertize nuk janë kontestuar nga palët ndërgjyqëse. Po

ashtu, Gjykata e Apelit, në aktvendimin me të cilin e ka kthyer çështjen në rigjykim dhe rivendosje, nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje apo sugjerim në drejtim të të gjeturave të kësaj ekspertize.

Mbi bazën e të gjitha arsyeve të elaboruara më sipër, Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a, me seli në Prishtinë, përmes së cilës ka kërkuar që të detyrohet i padituri L.B nga P, ta lirojë nga njerëzit dhe sendet dhe t'ia dorëzojë paditëses paluajtshmërinë e cila gjendet në fshatin G.P, vendi i quajtur "B", e cila evidentohet si ngastra kadastrale P-345-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 441 m², ZK F.K, si dhe ta rrënojë objektin - strukturën ndërtimore në sipërfaqe prej 62 m², të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

- Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës -

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës, nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore nga nenet 450 lidhur me nenin 463.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, për faktin se pala paditëse e ka humbur kontestin gjyqësor, kurse pala e paditur, si palë gjyqfituese nuk i ka kërkuar apo specifikuar shpenzimet e krijuara lidhur me këtë procedurë.

Mbi bazën e të lartëcekurave, në mbështetje të dispozitave nga nenet 142, lidhur me nenin 160 të LPK-së, u vendos decidivisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL -
C.nr.2819/22, datë 19.06.2024

G j y q t a r i,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, në kuptim të dispozitës nga neni 176 të LPK-së, palët e pakënaqura kanë të drejtën e ankesës në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.